



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTR
OLLI I
LARTË**

**I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. Prot. Tiranë, më /2018

V E N D I M

Nr. 149, Datë 28.09.2018

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
“MENAXHIMI I ZONAVE TË MBROJTURA DETARE”**

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 1035/3, datë 3.08.2018 realizoi auditimin e performancës me temë “Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura Detare”. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Vlorë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresat nr. 1035/4 datë 18.07.2018 iu dërgua projekt-raporti i auditimit institucioneve subjekt auditimi.

Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar observacionet e dërguara nga Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresë nr. prot. 64/2, datë 16.08.2018, protokolluar në KLSH me nr. prot. 1035/5, datë 22.08.2018.

Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe *projekt*-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit, të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

KONKLUDOVA

Organet që kryesisht ushtrojnë funksionet e tyre administrative në parkun detar dhe përreth tij janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura me degën e saj rajonale AdZM Vlorë, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Inspektorati i Peshkimit, dhe Inspektorati Rajonal Mjedisor. Të gjithë këto organe, sipas përkatësisë juridiksionale, në thelb kanë si qëllim ruajtjen e ZM. Megjithëse qëllimi është i përbashket, këto njësi më së shumti punojnë më vete, pa u koordinuar mes tyre dhe vihet re se ka një mungesë shkëmbimi informacioni duke cënuar kështu nivelin e eficiencës së procesit administrues të parkut. Gjithashtu, konstatohet se ka një mungesë bashkëpunimi më së shumti nga ana e inspektorateve të cilët duke qenë se ligji u jep kompetenca ndëshkuese ndaj shkelësve, konsiderohen si hallkë më “autoritare” duke e kërkuar ndihmën dhe bashkëpunimin e AdZM, por jo anasjelltas, kryesisht në shkëmbimin e informacioneve. Po kështu, problematike është edhe niveli i bashkëpunimit me AKB, pasi një milje nga vija bregdetare në drejtim të tokës, AKB ushtron funksion monitorimi njësoj si AKZM, por shkëmbimi i informacionit është në nivele shumë të dobëta, madje nga AKZM cilësohet se me këtë organ nuk ka pothuajse fare komunikim. I gjithë ky kaos në administrimin e PKD dhe mbivendosjeve apo mos bashkëpunimit mes aktorëve të përfshirë, ka ardhur si pasojë e mungesës së një kuadri rregullator të mirëfilltë për zonat e mbrojtura prej vitesh. Në mungesë të një administrate të posaçme përgjegjëse për zonat e mbrojtura, administrimi i tyre është bërë në copëza, sipas kuadrit ligjor të aktorëve të përfshirë. Është fakt se që prej vitit 2010, vendi ynë edhe pse me potencial të konsiderueshëm, ka mbetur vetëm me një zonë të mbrojtur detare, pra nuk i është kushtuar vëmendja e duhur kësaj kategorie. Ky fakt vihet re edhe në të dhënat që i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit, ku për periudhën objekt auditimi 2015-2017, fondet për investime për AKZM kanë qenë në rënie, ndërsa për AdZM Vlorë në rastin konkret, buxheti i akorduar për periudhën objekt auditimi mbulon vetëm paga, sigurime dhe shpenzime operative dhe nuk është parashikuar asnjë investim. Vetëm në vitin 2015, ky park arriti të ketë një dokument specifik me objektiva të qarta për menaxhimin e tij. Megjithatë që nga viti 2010 edhe në vazhdim, për shkak të kompleksitetit administrativ që shfaq kjo zonë, kanë munguar planet e veprimit konkrete dhe protokollat e bashkëpunimit. Vihet re një bashkëpunim formal institucional i detyruar nga ligji, por një mungesë vullneti për ta konkretizuar atë në veprime konkrete. Parku Kombëtar i Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit është krijuar të ofrojë një qasje pragmatiste që synon vendosjen e ekuilibrit ndërmjet zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe ruajtjes së burimeve natyrore duke siguruar mbrojtjen afatgjatë dhe mirëmbajtjen e biodiversitetit, teksa ofron në të njëjtën kohë një rrjedhë të qëndrueshme të produkteve natyrore dhe shërbimeve për të mbështetur zhvillimin e komuniteteve bregdetare¹. Objektivat kryesore të krijimit të tij janë përkthyer në një plan menaxhimi, i cili i zbërthen këto kategori në nën objektiva të parashikuara për tu realizuar në një periudhë 10 vjeçare. Referuar periudhës së miratimit të planit të menaxhimit dhe periudhës objekt auditimi, grupi i auditimit është përqëndruar në shqyrtimin e përmbushjes së objektivave që kanë si afat realizimi vitin e parë dhe të dytë të implementimit (2016-2017).

Plani i menaxhimit është hartuar me objektiva të qarta, të grupuara në kategori sipas interesit dhe vlerave që mbart kjo zonë, si dhe të skeduluara në afate kohore, por nuk shoqërohet me një plan veprimi, pra nuk janë të pasqyruara masat dhe veprimet konkrete që do ndërmarrë kjo administratë për arritjen e këtyre objektivave. Po ashtu, në planin e menaxhimit janë

¹ Plani i Menaxhimit të PKD

parashikuar aktorët që do përfshihen për realizimin e secilit objektiv, por AKZM/AdZM nuk ka marrë masa për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me këta aktorë që të garantojnë përfshirjen e tyre.

Hartimi i planit të menaxhimit është bërë në kuadër të projektit “Përmirësimi i Mbulimit dhe Efektivitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare” të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) financuar nga Fondi Global për Mjedisin (GEF) dhe bashkë-financuar nga Ministria e Mjedisit dhe UNDP, pra është hartuar duke u bazuar në planet e investimeve që kjo organizatë ka parashikuar. Mirë administrimi i këtij parku nuk rezultoi të ketë qenë në fokusin e qeverisë dhe në rast se ky plan menaxhimi nuk do të mbështetej nga projekti, këto objektiva do të ishin tepër ambicioze për tu realizuar vetëm nga AdZM Vlorë. Duke marrë parasysh kapacitetet tepër të limituara të AdZM Vlorë, si në burime njerëzore ashtu edhe financiare (referuar buxhetit të AdZM për vitet 2015-2017 nuk është parashikuar asnjë investim), nuk ka patur një studim SMART gjatë përpilimit të objektivave nëse ato mund të përmbushen me kushtet që kjo administratë ka, krahas mbështetjes së projektit. Deri më tani, plani i menaxhimit të PKD është realizuar me ndihmën e projekteve dhe me përkushtimin e një stafi shumë të vogël të cilët shpesh ndërmarrin edhe iniciativa private në funksion të përmbushjes së qëllimit të tyre mbrojtës dhe konservues (duhet mbajtur parasysh se vetëm me një staf prej rreth 17 rangers, nga të cilët 4 janë financuar nga projekti, kjo administratë duhet të menaxhojë të gjithë zonat e mbrojtura Vlorë-Sarandë). Për shkak të kompetencave dhe burimeve të kufizuara që kjo administratë ka, ajo nuk arrin të realizojë një monitorim dhe kontroll efektiv të zonës nën juridiksion. Konkretisht AdZM Vlorë nuk ka të dhëna dhe statistika të sakta dhe zyrtare mbi numrin e vizitorëve dhe zhytësve që aksesojnë parkun, specieve të peshkuara, etj, pasi:

- së pari mungon një mekanizëm financiar i cili përveç se do të sillte të ardhura nga shitja e biletave do të bënte të mundur edhe kontrollin e flukseve të përdoruesve në park. Lidhur me këtë, përmendim edhe faktin se që në fillim të hartimit të planit të menaxhimit, nuk janë marrë masa për realizimin e një studimi mbi kapacitetet mbajtëse për përdoruesit.
- së dyti, kuadri rregullator i deri tanishëm për këtë administratë, nuk parashikon marrjen e lejeve paraprake nga individë apo operatorë të ndryshëm të cilët duan të ushtrojnë veprimtari të çdo lloji në park.
- së treti, ka një mungesë bashkëpunimi me aktorët e tjerë të përfshirë në këtë zonë (trajtuar në nën pyetjen e parë).

Progresi i deri tanishëm lidhur me zbatimin e planit të menaxhimit, është realizuar me mbështetjen e vazhdueshme të financimit nga projekte të ndryshme. Megjithatë nga vlerësimi i bërë nga (Metoda e Vlerësimit të Efektivitetit të Menaxhimit) MEET², vihet re një përmirësim i konsiderueshëm në përmbushjen e planit të menaxhimit, për disa objektiva të cilat trajtohen gjerësisht më poshtë, hasen edhe vonesa. Zonat e mbrojtura detare janë një koncept i ri jo vetëm për komunitetet dhe përdoruesit por edhe për institucionet. Për rrjedhojë baza ligjore, njohuritë e institucioneve dhe praktikat e ngritura nuk janë të plota. Ende nuk ka një bashkëpunim eficient midis administratës dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese, lidhur kryesisht me: dhënien e lejeve për ushtrim aktivitetesh, leje mjedisore, ndjekjen e mëtejshme të rasteve të shkeljeve të konstatuara nga AdZM, si dhe shkëmbim informacioni mbi përdorues të detit. Baza materiale në funksion të menaxhimit dhe monitorimit të parkut është ende e kufizuar, kryesisht lidhur me mjetet detare, pikat e ankorimit, shenjat kufizuese të parkut etj. Gjithashtu ekspertiza shkencore dhe studimet e realizuara janë të pamjaftueshme për të përcaktuar qartë

² Metoda e Vlerësimit të Efektivitetit të Menaxhimit – një instrument vlerësimi i përgatitur nga Komisioni Botëror për Zonat e Mbrojtura.

masat mbrojtëse që duhen ndjekur dhe në vazhdim impakti i tyre. Një pengesë të konsiderueshme përbën edhe stafi i kufizuar për menaxhimin e PKD dhe në mënyrë të veçantë në periudhën e sezonit turistik. Nën pyetjet më poshtë, shtjellojnë ecurinë e objektivave kryesore të parashikuara për tu implementuar gjatë dy viteve të para të planit të menaxhimit.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë ***“Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura Detare”***, të ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Vlorë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

I. Për Pyetjen: A janë të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve që përfshihen në mbrojtjen e parkut detar?

Gjetje:

- Nuk ka pasur të hartuar apo të miratuar asnjë ligj apo politikë veçanërisht për zonat e mbrojtura detare, deri në maj 2017, kur me miratimin e ligjit të ri nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, kësaj kategorie i’u dedikua një hapësirë edhe pse fare e vogël, nëpërmjet nenit 22.
- Deri në vitin 2015, ka patur një ligj për zonat e mbrojtura, por jo një administratë të mirëfilltë për zonat e mbrojtura. Megjithëse ngritja e kësaj administrate parashikohej në ligjin për zonat e mbrojtura të miratuar në vitin 2002, kjo administratë nuk ka ekzistuar deri në vitin 2015.
- AKZM/AdZM, kryen inspektime për veprimtaritë që ndodhin në zonën e mbrojtur, por në rast konstatimesh të shkeljeve të parashikuara në ligj, ajo duhet të njoftojë menjëherë inspektoratet përkatëse që kanë kompetenca vendimarrëse dhe ndëshkuese ndaj shkelësve dhe këtu përfundon misioni i asaj në mbrojtje të zones, pasi AdZM nuk merr më asnjë feedback nga këto inspektorate mbi masat e marra ndaj kundravajtësve.
- AKZM nuk ka kompetenca për të ushtruar një kontroll të mirëfilltë mbi veprimtaritë që ndodhin në zonën e mbrojtur. AdZM Vlorë e ka të pamundur të kontrollojë vizitorët, turistët, zhytësit, mjetet e vogla lundruese, apo përdorues të tjerë të cilët hyjnë në park, pasi ata paraprakisht nuk paraqiten askund për të përfituar një leje për hyrjen dhe përdorimin e parkut.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit 2016-2021, në asnjë rast nuk ka përfshirë si partnere ndihmëse Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, duke qenë se ajo është përgjegjëse edhe për shumë zona të tjera bregdetare të mbrojtura në të cilat zhvillohen aktivitete peshkimi.
- AdZM nuk vihet në dijeni mbi urdhrat e ndalimit të peshkimit të lëshuara nga Ministria/inspektorati përkatës për periudhat e ripopullimit të specieve, shpalljen e zonave të ndaluara të peshkimit, etj. Po kështu, AKZM/AdZM Vlorë nuk janë përfshirë për konsultim gjatë diskutimeve për draftimin e Ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën”.

- Në Strategjinë Kombëtare për Turizmin, megjithëse ende një draft, në aktivitetet kryesore për realizimin e objektivave nuk parashikohet asnjë bashkëpunim me AKZM, sidomos për drejtimitet e përbashkëta strategjike që lidhen me zonat që ajo administron
- Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, për periudhën e auditimit 2015-2017 është mbledhur vetëm 3 herë (Janar 2015, Janar 2016, Shtator 2016), ndërkohë që ka detyrimin të mbledhet jo më pak se dy herë në vit.

Për sa më sipër rekomandoj

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM dhe AdZM Vlorë, të marrin masa për hartimin e protokolleve apo marrëveshjeve të bashkëpunimit me grupet e interesit që operojnë në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan (qoftë njësi publike, apo shoqëri civile), ku të pasqyrohen veprime konkrete dhe të koordinuara nga secila palë në funksion të një procesi monitories sa më eficient. Kjo praktikë të ndiqet jo vetëm për këtë rast, por edhe për parqet detare që janë në pritje të miratimit të statusit “Zonë e Mbrojtur Detare”.

Brenda fillimit të sezonit të ardhshëm turistik

- Komiteti i Menaxhimit të PKD, të fuqizojë rolin e tij llogari kërkues, jo vetëm në shqyrtimin e implementimit të Planit të Menaxhimit të PKD, por edhe në nxitjen e bashkëpunimit mes aktorëve të përfshirë në administrimin e këtij parku, duke qenë se ka në përbërje anëtar nga çdo njësi që ushtron funksion administrues në park.

Në vijimësi

II. Për Pyetjen: A janë marrë masa nga aktorët e përfshirë në mbrojtjen e parkut për përafrimin e legjislacionit në përgjigje të ndryshimeve thelbësore që kanë ndodhur në administrimin e parkut detar në vitet e fundit?

Gjetje:

- Çdo përdorues i zonës së mbrojtur, qoftë turist, visitor, peshkatar, apo zhytës mund të hyjë lirisht në këtë park dhe të ushtrojë veprimtari të pakontrolluar, pasi AdZM nuk ka kompetenca për dhënie leje për përdoruesit e parkut.
- Ligji nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, njeh dhe parashikon bashkërendimin e veprimeve me të gjithë palët e përfshira në veprimtaritë e zhvilluara brenda zonave të mbrojtura, ndërkohë që pjesa tjetër e kuadrit rregullator që përfshihen në këtë çështje ende nuk kanë marrë masa për përditësimin e akteve ligjore përkatëse.
- Në nenin 33 të ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” i cili përcakton veprimtaritë që lejohen në këto zona, nuk parashikohet asnjë procedure pajisje me leje apo qoftë edhe konsultimi paraprak me AdZM përkatëse, përpara ndërhyrjeve.
- Në afërsi të zonës së mbrojtur prej vitesh zhvillojnë aktivitetin 6 subjekte akuakulture të cilat bien ndesh me statusin e zonës dhe për të cilat nuk dihen efektet që shkakton në këtë zonë, pasi mungojnë studimet e nevojshme për impaktin e tyre në det dhe në tokë. Po kështu, nuk janë marrë masa për vlerësimin e pranisë së tyre në këtë zonë pas miratimit të Ligjit nr. 103/2016, datë 20.10.2016, sipas të cilit pritet të përpilohen aktet nënligjore përkatëse për përcaktimin e zonave për ushtrimin e aktiviteteve të akuakulturës.
- Nuk janë marrë masa për hartimin e akteve nënligjore në funksion të Ligjit nr. 103/2016, datë 20.10.2016 “Për akuakulturën” dhe konkretisht ende nuk janë vendosur “Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë”.

- Kuadri rregullator që lidhet me mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja, peshkimin, aktivitetet ushtarake brenda zonës së mbrojtur, apo ushtrimi i sporteve nënujore, nuk është përditësuar pas ngritjes së AKZM, duke e përfshirë këtë të fundit si një nga organet kryesore bashkëpunuese në administrimin e PKD.
- Megjithëse me hyrjen në fuqi të ligjit të ri mbi zonat e mbrojtura, AdZM ka të drejtën e ngritjes së padive penale ndaj veprimtarive në shkelje të këtij ligji, ende nuk ka akte nënligjore dhe referenca që përcaktojnë mënyrat e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara.

Për sa më sipër rekomandoj

- AKZM dhe AdZM Vlorë, të nisin procedurat për propozimin e akteve nënligjore në funksion të Ligjit nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, ku të përcaktohen qartë kompetencat e AKZM/AdZM-ve në lejimin apo ndalimin e ushtrimit të aktiviteteve apo sporteve ujore brenda zonës, vizitat në pikat që përbëjnë atraksion turistik, etj. Me miratimin e këtij kuadri rregullator, të merren masa për realizimin e fushatave të nevojshme informuese mbi faktin se për aksesimin e PKD Karaburun-Sazan, më parë duhet të vihet në dijeni edhe administrata menaxhuese e tij.

Brenda sezonit të ardhshëm turistik

- AKZM dhe AdZM Vlorë, me ndihmën edhe të ekspertëve të fushës, të marrin masa për propozimin e akteve nënligjore në funksion të Ligjit nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, ku të përcaktohen qartë referencat dhe mënyrat e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga shkelësit në zonën e mbrojtur. Gjithashtu, të merren masa për propozimin e kategorizimit të penaliteteve ndaj shkelësve, duke vendosur penalizime më të mëdha për shkeljet që ndodhin brenda zonave të mbrojtura.

Brenda vitit 2019

- Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe AdZM Vlorë, të marrin masa për krijimin e një komunikimi të ndërsjellë për çdo rast nxjerrjesh njoftimesh, urdhërash, apo akte të tjera administrative që lidhen me lejimin apo ndalimin e aktiviteteve të peshkimit dhe akuakulturës brenda apo në afërsi të zonë së mbrojtur, si dhe nëpërmjet inspektorëve përkatës të verë në dijeni AdZM mbi ecurinë dhe rezultatet e masave të marra ndaj shkelësve, që vijnë nga sinjalizimet e AdZM.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM, AdZM dhe me ndihmën e ekspertëve të fushës, të marrin masa për realizimin e studimeve të thelluara shkencore mbi zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës në afërsi të zonave të mbrojtura detare, që nga studimi i kapaciteteve mbajtëse të gjirit të Vlorës, e deri në vlerësimin e dëmeve të akumuluar dhe ato potenciale në të ardhmen. Në këtë kontekst, këto organe të marrin masa për mos dhënien e lejeve të ushtrimit të kësaj veprimtarie deri në publikimin e rezultateve përfundimtare të studimeve. Në rast se nga këto studime del e nevojshme, të merren masa edhe për pezullimin e aktiviteteve që operojnë aktualisht në afërsi të kësaj zone. Po kështu, të veprohet edhe për rastet e Zonave të Përcaktuara të Akuakulturës referuar Ligjit nr. 103/2016, datë 20.10.2016 “Për Akuakulturën”, të cilat të përcaktohen vetëm pas zhvillimit të studimeve shkencore dhe jo sipas interesit të subjekteve private.

Brenda vitit 2019

III. Për Pyetjen: A është realizuar ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe vlerave kulturore e historike të parkut detar në përputhje me objektivat e vendosura?

Gjetje:

- Prioriteti kohor që i është dhënë disa prej objektivave nuk është i duhuri, pasi sipas këtij plani menaxhimi në dy vitet e para do kryhen aktivitete monitoruese, vëzhguese apo rregulluese dhe më pas do kryhen studime apo kërkime për shtrirjen dhe nivelin e kërcënimit të këtyre habitateve dhe hartëzimit të tyre.
- Pjesa nënujore e Karaburun-Sazanit nuk është eksploruar shumë. Studimet kryesore në zonë janë kryer nga organizata të huaja ose me mbështetjen e tyre, pasi AKZM/AdZM nuk ka kapacitetet e nevojshme financiare apo logjistike për zhvillimin e tyre individualisht.
- Ende nuk është implementuar një skemë për rregullimin e varkave turistike edhe për faktin se AdZM Vlorë ende nuk ka një studim mbi kapacitetet mbajtëse të zonës apo një mekanizëm kontrolli për përdoruesit e saj.
- Ende nuk është hartuar një kod sjellje për soditjen e specieve të egra. Aktualisht AdZM ka një protokoll për monitorimin e tyre, i cili shërben si orientues për këtë veprimtari.
- Është realizuar identifikimi dhe inventarizimi i shpellave tokësore por jo i atyre nënujore.
- Nuk janë marrë masa për ngritjen e strukturave të nevojshme (bova) për ankorimin e mjeteve që sjellin vizitorë në shpella, si dhe mungon një rregullore për përdorimin e tyre nga vizitorët, distancat e lejuara për hyrjen në shpella, etj.
- Është vonuar së tepërmi procesi i shpalljes së zonës së Porto Palermos dhe Kepit të Rodonit si ekosisteme të propozuara për tu shpallur zonë e mbrojtur detare. Miratimi i ZPA në këto hapësira do të ishte në kundërshtim me potencialin që këto zona kanë për vlerat e tyre të ekosistemit.
- Nga Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit nuk janë marrë masa për vlerësimin e pranisë apo shkatërrimin e subjekteve të shërbimit të ngritura brenda zonës së mbrojtur në sezonin veror dhe që sinjalizohen rregullisht nga AdZM Vlorë.

Për sa më sipër rekomandoj

- AKZM dhe AdZM Vlorë të marrin masa për përmbushjen plotësisht të objektivave të parashikuara për zbatim në dy vitet e para, të cilat janë realizuar pjesërisht deri në periudhën objekt auditimi. Për këtë, të merren masa për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitetin e Vlorës dhe atë Bujqësor të Tiranës, për kryerjen e studimeve të nevojshme në mënyrë që të përcaktohen më tej masat mbrojtëse dhe rregulloret e duhura për përdorimin e ekosistemit.

Brenda nisjes së sezonit të ardhshëm turistik

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM dhe AdZM të llobojnë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar mbi vlerat dhe rëndësinë e këtij ekosistemi në rajonin e Mesdheut, në mënyrë që të përthithen sa më tepër projekte në mbrojtje të kësaj zone.

Në vijimësi

- Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, të shqyrtojë mundësinë e rialokimit të buxhetit në dispozicion, në mënyrë që në të ardhmen të përcaktohen fonde për investime edhe për AdZM Vlorë.

Me hartimin e buxhetit për vitin pasardhës

IV. Për Pyetjen: Çfarë masash janë marrë për të mbështetur zhvillimin e komunitetit vendas nëpërmjet peshkimit dhe turizmit të qëndrueshëm?

Gjetje:

- Ende nuk ka një studim të plotë social-ekonomik mbi peshkimin lokal. Është zhvilluar një studim mbi llojet dhe trendet e këtyre specieve në zonën Karaburun-Sazan, megjithatë AdZM ende nuk zotëron një vlerësim të plotë të bazës së rezervave të peshkut.
- Shkeljet kryesore lidhen me zjarr vënie, ngritjen e strukturave të lehta të shërbimit gjatë sezonit veror, gjueti e paligjshme dhe gjueti nga peshkarexha me mjete ndriçuese të tipit fenerë.
- Numri më i madh i inspektimeve kryhet nga toka, për pamundësi financiare për të përdorur rregullisht mjetin lundrues dhe vetëm gjatë orarit zyrtar të punës, ndërkohë që pjesa më e madhe e aktivitetit peshkues zhvillohet gjatë natës.
- Është hartuar një listë me atraksionet kryesore turistike, por ende nuk ka një hartë të plotë të tyre pasi lista ka nevojë për përditësime.
- Është arritur një marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes për lehtësimin e procedurave të aksesit në park nga deti, megjithatë, për aksesin nga toka ende ka problematika dhe paqartësi mbi procedurën që duhet ndjekur.
- AdZM nuk ka të identifikuar plotësisht subjektet që ushtrojnë sportin e zhytjes dhe statistika të sakta mbi numrin e vizitorëve të atraksioneve nënujore. Një fakt i tillë haset edhe nga Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Nuk është krijuar infrastruktura e duhur për ushtrimin e sportit të zhytjes si, hartimi i shtigjeve nënujore, identifikimi i shpellave nënujore, vendosja e bovave në pikat e parashikuara për zhytje, etj.
- Ka një mos përputhje mes pikave të përcaktuara për zhytje nga AdZM si pika me interes historik e kulturor, me ato të përcaktuara nga VKM nr. 321, datë 28.5.2014, i ndryshuar, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”. Po kështu, referuar këtij vendimi, është e pa qartë mënyra e përdorimit të pjesës perëndimore të gadishullit të Karaburunit si zonë për përdorim publik nga vizitorët dhe pushuesit, pasi AdZM nuk ka një bashkëpunim produktiv me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Për sa më sipër rekomandoj

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM dhe AdZM të marrin masa për miratimin dhe zbatimin sa më parë të një mekanizmi financiar nëpërmjet shitjes së biletave për vizitorët e parkut, në mënyrë që të krijojë edhe një burim të ardhurash. Për këtë, këto organe të ndërmarrin një studim fizibiliteti për përcaktimin e kostove dhe përfitimeve, si dhe të kryejnë një analizë mbi mundësinë e vendosjes së këtyre mekanizmave, duke studiuar pikat më me fluks nga mbërrijnë vizitorët. Nëpërmjet këtij mekanizmi do të bëhej e mundur edhe kontrolli i numrit të përdoruesve duke përfutur shifra më të sakta.

Brenda nisjes së sezonit të ardhshëm turistik

- Për sa më lart, organet e mësipërme të marrin masa për vendosjen e sinjalistikave dhe shpërndarjen e informacioneve mbi pikat e vendosura si në plazhet e pjesës lindore ashtu edhe të asaj perëndimore të Karaburunit, gjithashtu edhe nëpërmjet operatorëve turistikë.

Brenda nisjes së sezonit të ardhshëm turistik

- AKZM dhe AdZM Vlorë të marrin masa për zhvillimin e një studimi mbi kapacitetet mbajtëse të Parkut në tërësi dhe sipas aktiviteteve që ushtrohen në të në veçanti.

Brenda vitit 2019

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM dhe AdZM, të marrin masa për të zhvilluar konsultime me të gjithë palët e prekura nga VKM nr. 321, datë 28.05.2014, “Për sigurinë në

det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, lidhur me mos përputhjet që konstatohen për sa i përket përcaktimit të pikave të zhytjes të cilat përbëjnë atraktivitetet turistik, kulturor e historik, si dhe përdorimit të zonës perëndimore të Karaburunit (mbi plazhin e Dhërmiut) si zonë publike për pushim dhe plazh.

Brenda nisjes së sezonit të ardhshëm turistik

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM, AdZM dhe me ndihmën e Komitetit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur, të ndërmarrin diskutime edhe me palët e interesit për hartimin e një kuadri rregullator të dedikuar sportit të zhytjes, duke përcaktuar qartë identifikimin dhe regjistrimin e këtyre subjekteve, lejimin/licensimin apo mënyrat e çertifikimit, zonat e përcaktuara për ushtrimin e këtij sporti, mënyrat dhe pajisjet e lejuara apo të ndaluara, etj.

Menjëherë pas publikimit të raportit përfundimtar

V. Për Pyetjen: A janë marrë masa për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut, vizitorëve dhe përdoruesve të parkut detar lidhur me ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve?

Gjetje:

- Veprimet e ndërmarra në funksion të ndërgjegjësimin të komunitetit vendas dhe publikut, janë kufizuar në nivel lokal edhe pse vizitorët dhe përdoruesit e këtij parku janë në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare gjithashtu. Aktivitetet që vetë AdZM ka zhvilluar, i janë dedikuar kryesisht nxënësve dhe studentëve të qytetit të Vlorës.
- Pavarësisht se qëndra e vizitorëve është kompletuar me informacione e fletëpalosje informuese dhe është në dispozicion të turistëve për pyetjet që ata kanë, këto të dhëna mbeten për tu marrë vetëm në rast se vizitorët zgjedhin të paraqiten pranë kësaj qendre. Në këtë aspekt, ka munguar përfshirja maksimale edhe e vetë AKZM.
- Pavarësisht përpjekieve për të rritur nivelin e ndërgjegjësimin, shkeljet e konstatuara në këtë zonë vijojnë të jenë të njëjtat.

Për sa më sipër rekomandoj

- Krahas AdZM Vlorë edhe AKZM, me ndihmën e shoqatave apo grupeve të interesit, të marrë masa që të përfshihet maksimalisht në realizimin e fushatave promovuese mbi vlerat, pasuritë dhe përfitimet që sjell mbrojtja e këtij ekosistemi, si dhe fushata informuese mbi veprimtaritë e lejuara, ato të ndaluara, dhe penalizimet që vijnë në rast shkeljesh, jo vetëm në zonën e Vlorës, por në të gjithë territorin e Republikës dhe për të gjithë grupmoshat. Në këtë kontekst, AKZM të marrë masa për realizimin e publicitetëve audio dhe vizive gjatë të gjithë periudhës dhe më intensive në prag të fillimit të sezonit turistik veror.

Në vijimësi

VI. Për Pyetjen: A ka AdZM Vlorë kapacitetet dhe burimet e nevojshme financiare për menaxhimin efektiv të parkut?

Gjetje:

- Puna e administratës ndesh vështirësi në monitorimin e flukseve në PKD kryesisht gjatë sezonit veror.
- AdZM Vlorë i ka ka munguar mbështetja e duhur e grupeve të interesit apo universiteteve lidhur me monitorimet shkencore të habitateve dhe llojeve.

- Në mungesë të fondeve për investim, si dhe të ngritjes së një mekanizmi financiar për vendosjen e tarifave për përdoruesit e parkut, kjo administratë nuk zotëron një burim krijimi të ardhurash, të cilat do ti vinin në ndihmë në përmbushje të funksioneve të saj.
- AdZM nuk zotëron mjete dhe pajisje të mjaftueshme për të monitoruar një hapësirë kaq të madhe dhe me distancë të konsiderueshme.
- Ka vështirësi në mbulimin e kostove të përdorimit dhe mirëmbajtjes së mjetit lundrues, si dhe në mënyrë të veçantë për mbulimin e pjesës perëndimore të parkut, e cila është më e vështirë për tu arritur në kohë me det të trazuar.

Për sa më sipër rekomandoj

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të shikojë mundësinë për vënie në dispozicion të AdZM Vlorë të një buxheti më të lartë në vitet në vijim, për periudhat që përkojnë me rritjen e flukseve, të paktën për të përballuar një monitorim të rregullt me anë të mjetit lundrues.

Me hartimin e buxhetit për vitin pasardhës

- AKZM dhe AdZM Vlorë, duke ju referuar VKM nr. 1703, datë 24.12.2008 “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe të veprimtarive sezonale/të përkohshme për Ministrinë dhe institucionet buxhetore”, sipas nevojës të marrin masa për propozimin e vënies në dispozicion të një stafi sezonal (rangers) me kontratë të përkohshme, për përballimin e fluksit dhe rritjen e aktiviteteve monitoruese, për periudhat Qershor-Shtator.

Çdo vit për periudhën qershor-shtator

- AKZM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, referuar edhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të analizojnë mundësinë dhe të propozojnë krijimin e administrative të dedikuara për zonat e mbrojtura, për arritjen e një procesi menaxhues sa më efektiv të këtyre zonave.

Brenda një periudhe dy vjeçare

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Shënim: Ky auditim vlerësohet dobët nga Kryetari dhe Drejtori i Departamentit. Do përsëritet përgjatë vitit 2019 duke e vendosur theksin tek raportet me AKB dhe fuqizimin e rolit të saj si një agjenci më e specializuar në këtë fushë dhe problematika të tjera që janë trajtuar dobët në këtë auditim ose nuk janë trajtuar.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R